

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar–mars 2021
- Tregtimi i Titujve në Bursën ALSE, janar–mars 2021

Zhvillime të tjera

- AMF dhe INSTAT nënshkruajnë Memorandum Bashkëpunimi për Programin e Statistikave Zyrtare
- AMF nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës
- AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren "Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese e depozitarëve"

Publikime Profesionale

- BIS Madhësia e investitorit, likuiditeti dhe stresi i fondit kryesor të tregut të parave
- EIOPA *Podcast*: "Coronavirusi, konsumatorët dhe tregu i sigurimeve"
- GRR Global Risk Regulator
- IAIS/FSI Ripërcaktimi i mbikëqyrjes së sigurimeve për "normalitetin e ri" – publikim i përbashkët IAIS-FSI
- IOPS Publikohet "Material Diskutimi" Nr. 36, prill 2021, i IOPS-it rreth mbikëqyrjes efektive të pensioneve - "Mbikëqyrja e investimeve në infrastrukturë nga fondet e pensionit"

Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari
- Poloni
- Republika e Sllovakisë
- Sllovenia

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar-mars 2021

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit në periudhën janar-mars 2021 arritën vlerën 4,039 milionë lekë, ose 12.52% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë periudhës janar-mars 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 202,944 me një ulje prej 15.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.71% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë sigurimet e Jetës me 7.27%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 44.10% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 55.90% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-mars 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,083 milionë lekë, ose 8.27% më pak se gjatë periudhës janar-mars 2020.

Gjatë periudhës janar-mars 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 1,007 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 50.29% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë periudhës janar-mars 2021, dëmet e paguara bruto të sigurimit motorik kapën vlerën 1,007 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 50.29% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-mars 2021



VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregtimi i titujve në Bursën ALSE, 3-mujori i parë 2021

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë 3-mujorit të parë të 2021, në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 6,186,524 lekë dhe Obligacione Thesari në vlerën prej 234,533,530 lekë. Duke analizuar volumin për njësi të tregtuara, numrin e transaksioneve dhe vlerën e tregtuar, gjatë këtij 3-mujori, kanë dominuar transaksionet *off-exchange*,

Nga të dhënat e tregimit në ALSE, për 3-mujorin e parë të vitit 2021, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar në volum, vlerë dhe numër, transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve.

Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R.Sh. në Bursën ALSE

Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregimit (Në lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
për Anëtarët	0	0
për Klientët	6,186,524	234,533,530
Individë	6,186,524	65,774,030
Persona Juridike	0	168,759,500
TOTAL	6,186,524	234,533,530

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 në Bursën ALSE kanë dominuar transaksionet e kryera për llogari të klientëve.



AMF dhe INSTAT nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi për Programin e Statistikave Zyrtare

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Instituti i Statistikave nënshkruan Memorandumin e Bashkëpunimit, i cili përcakton përgjegjësitë në funksion të shkëmbimit të informacionit dhe transmetimit të të dhënave për Programin e Statistikave Zyrtare. Memorandumi i bashkëpunimit u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete dhe Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, znj. Elsa Dhuli. Marrëveshja synon të rrisë performancën e funksionimit të Sistemit Kombëtar Statistikor, duke rregulluar mënyrën e organizimit të punës, transmetimit të statistikave dhe të dhënave të ndryshme, si edhe detyrimet e ndërsjella institucionale në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Palët do të bashkëpunojnë gjithashtu në hartimin e planeve të punës në fushën e statistikave, përmirësimin e metodave dhe teknikave ekzistuese në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si edhe në shkëmbimin e rregullt të dokumenteve formalë e teknikë. AMF dhe INSTAT bien dakord të bashkëpunojnë për realizimin e anketave dhe vrojtimeve statistikore të bizneseve dhe qytetarëve për tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve/investitorëve, si edhe nxitjes së transparencës, besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në këto tregje.

AMF nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi me Autoritetin e Konkurrencës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Autoriteti i Konkurrencës nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi, i cili ka si qëllim bashkëpunimin ndërmjet palëve me qëllim mbrojtjen e konsumatorit/investitorit përmes garantimit të konkurrencës së lirë në tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së. Memorandumi i Bashkëpunimit u nënshkrua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, z. Ervin Mete dhe Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, znj. Juliana Latifi.

Marrëveshja parashikon bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional përmes shkëmbimit të informacionit, akteve ligjore e rregullatore, si edhe organizimin e takimeve të përbashkëta në funksion të mirërregullimit të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Memorandumi i Bashkëpunimit, i cili rinovon marrëveshjen e nënshkruar në vitin 2006 mes dy institucioneve, përcakton linja të qarta në kuadër të bashkërendimit të mëtejshëm të veprimeve dhe mbështetjes reciproke në funksion të konkurrencës së lirë dhe efektive në tregjet financiare jobankare.

Kontakt Shqip

amf
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

AMF - Legjislacioni - Stabiliteti Financiar - Mbrojtja e Konsumatorit - Edukimi Financiar - Regjistri i të Licencuarve - Programi i Transparencës - Publikime

Projekte

Faqe Kryesore » Legjislacioni » Projekte »
Projektregullore "Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve"

Projektregullore "Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve"

Materiali i plotë

VERIFIKONI POLICËN TUJ

DEPOZITO ANKESËN ONLINE

AMF nxjerr për konsultim publik projektregullore "Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve"

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në zbatim të Ligjit nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", ka hartuar projektregullore "Mbi përmbajtjen, afatet kohore dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive administruese dhe depozitarëve".

Projektregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm:

<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=61>

BIS

Quarterly Review

March 2021

BIS Quaterly Review – Revista e “Bank for International Settlements” pasqyron zhvillimet e sistemit bankar ndërkombëtar dhe tregjeve financiare.

Mars 2021

<https://www.bis.org>

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikullin:

Madhësia e investitorit, likuiditeti dhe stresi i fondit kryesor të tregut të parave

(Investor size, liquidity and prime money market fund stress)

Fernando Avalos
Dora Xia

https://www.bis.org/publ/qtrpdf/r_qt2103b.htm

(Marrë me shkurtime dhe redaktime)

Shlyerjet masive në Fondet e Tregut të Parave, (*Money Market Funds, MMFs*) duke investuar kryesisht në tituj të borxhit privat afatshkurtër me cilësi të lartë, ishin një tipar i rëndësishëm i zhvendosjeve të tregut në mars 2020.

Duke u bazuar në studimet e mëparshme, autorët zbuluan se tërheqjet e investitorëve të mëdhenj nuk bënë diferencime ndërmjet MMF-ve kryesore institucionale sipas pozicioneve të likuiditeteve aktive të këtyre fondeve. Autorët gjithashtu zbuluan se për t'u përballur me kërkesat e mëdha për shlyerje, menaxherët e këtyre fondeve, të cilët dispononin tituj më pak likuidë në portofolat e tyre, shënuan një ndryshim të sjelljes së tyre, duke u larguar nga ajo e kohërave të qeta. Kjo ka të ngjarë të ketë përkeqësuar mungesat e likuiditetit në të gjithë tregun. Pas njoftimit të Rezervës Federale për fondet e mbështetjes (*Money Market Mutual Fund Liquidity Facility*) të gjitha fondet forcuan pozicionet e tyre të likuiditetit.

Mësimet kryesore të nxjerra:

- ❑ Në mars të vitit 2020, fondet kryesore të tregut të parave që u shërbejnë investitorëve të mëdhenj, përjetuan tërheqje pavarësisht nga likuiditeti i aktiveve themelore;
- ❑ Gjatë tërheqjeve masive, menaxherët e fondeve kryesisht dhanë aktivet më pak likuide, gjë që mund të ketë përkeqësuar mungesat e likuiditetit në të gjithë tregun;
- ❑ Sapo u vendosën politikat mbështetëse dhe lehtësuese, menaxherët e fondeve rindërtuan mbrojtësit e likuiditetit dhe fondet e goditura më shumë nga tërheqjet e likuiditetit, i forcuan pozicionet e tyre të likuiditetit në mënyrë shumë më agresive.

... Më tej autorët shqyrtojnë “Menaxhimin e likuiditetit të fondeve gjatë këtyre ngjarjeve” (*Funds' liquidity management over the episode*)

Menaxherët e MMF-ve mund t'i përgjigjen kërkesave për shlyerje/tërheqje të mëdha të fondeve në dy mënyra alternative. Ata mund të shesin aktivet e tyre më likuide, në një përpjekje për të minimizuar kostot e transaksionit, veçanërisht në kushtet e likuiditetit akut të tregut. Por, duke vepruar kështu, ata do të dobësonin pozicionet e tyre të likuiditetit, duke i sjellë ato më afër pragjeve/ kufinjve rregullatorë dhe duke shkaktuar potencialisht tërheqje të mëtejshme. Ndryshe, ata mund të zgjedhin një mënyrë alternative, të ulin ato asete / zotërime të tyre që janë më pak likuide, në mënyrë që të ruajnë pozicionin e likuiditetit të fondit. Megjithatë, kjo mund të çojë në ulje më të mëdha të çmimeve dhe në këtë mënyrë humbje më të mëdha të kapitalit.

BIS

Quarterly Review

March 2021

Pamundësia e MMF-ve kryesore institucionale për të siguruar likuiditet sipas kërkesës në mars 2020 kërkoi ndërhyrje të Bankës Qendrore (FSB (2020a)). Ndryshe nga bankat, të cilat treguan se ishin amortizuese të dobishme gjatë trazirave të shkaktuara nga pandemia (Shin (2020), nxitimi i fondeve për likuiditete, shtoi stresin në tregjet financiare. Kështu, sigurimi i likuiditetit nga bankat qendrore ishte thelbësor në rivendosjen e qetësisë (CGFS (2011)).

Ngjarjet e marsit 2020 kanë lënë gjurmë të pashlyeshme. Ato i bënë jehonë ngjarjeve të krizës së madhe financiare në shtator 2008, kur sektori i MMF pësoi një ndikim të madh dhe gjithashtu kërkoi ndihmën e bankave qendrore.

Gjetjet e këtij artikulli ofrohen si një kontribut në debatin e vazhdueshëm rreth masave të politikave që mund të rrisin qëndrueshmërinë e MMF-ve.

The EIOPA podcast

Conversation, news and views



The EIOPA podcast takes a closer look at insurance and occupational pensions supervision in Europe, and EIOPA's work on these issues. Talking to experts from across the sector, the podcast brings you news and views on the latest developments and more.

The views expressed are those of the speakers and not necessarily those of the European Insurance and Occupational Pensions Authority.

CONSUMER PROTECTION

Podcast episode 2: Coronavirus, consumers and insurance

The coronavirus pandemic has not only changed the experience that consumers have with their insurance provider, but also their insurance needs. In this episode of the EIOPA Podcast, Irina Popa and Marco Traversa discuss how COVID-19 has impacted policyholders and what this means for insurers...

PODCAST | 21 APR 2021

Coronavirusi, konsumatorët dhe tregu i sigurimeve

Pandemia e COVID-19 ka ndryshuar jo vetëm marrëdhënien dhe eksperiencën që konsumatorët kanë me kompaninë e tyre të sigurimeve, por ka ndryshuar edhe nevojat që konsumatorët kanë për t'u siguruar. Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) ka filluar një seri komunikimesh profesionale publike nëpërmjet *podcast*-ve me tematika të ndryshme.

Në *podcast*-in e publikuar më 21 prill 2021, dy ekspertët Irina Popa dhe Marco Traversa diskutuan mënyrën se si COVID-19 ka ndikuar në zotëruesit e policave të sigurimit dhe çfarë do të thotë kjo për kompanitë e sigurimeve, mbikëqyrësit si edhe punën e autoritetit rregullator si EIOPA.

Në një seri të mëparshme të publikimeve, *podcast* i datës 24 shkurt 2021, i ftuar ishte Gabriel Bernardino, Kryetari në largim i EIOPA-s, i cili bëri një refleksion për 10 vitet e fundit në zhvillimin dhe ecurinë e punës së EIOPA-s dhe ndau mendimet e tij për të ardhmen.

Ju mund t'i ndiqni këto publikime në:

https://www.eiopa.europa.eu/media/eiopa-podcast_en



Proposed green asset ratio could inflict reputational damage on banks

Farah Khalique | April 6, 2021



A European Union proposal for a green asset ratio for banks is being touted as a wake-up call for the industry, but bankers question its feasibility and the risk of unfair reputational damage.

□ “Raporti i propozuar i aseteve të gjelbërta mund të shkaktojë dëm reputacional ndaj bankave”

(Proposed green asset ratio could inflict reputational damage on banks)

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance>

Një propozim i Bashkimit Evropian për krijimin e një raporti të aseteve të gjelbërta për bankat po vlerësohet si një thirrje zgjimi për industrinë. Por bankierët vënë në dyshim realizueshmërinë e këtij raporti dhe rrezikun e dëmtimit të padrejtë të reputacionit të bankave.


**Global Risk
Regulator**

□ Nevoja e hartuesit të standardit global të gjelbër për të nxitur miratimin e financave klimatike

(Green global standard setter needed to drive adoption of climate finance)

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Reporting-and-Governance>

Juridiksionet, si edhe autoritetet rregullatore të vendeve të ndryshme përgjithësisht ndjekin iniciativat e tyre të veçanta në fusha të tilla si standardet për Bonot e gjelbërta. Por a duhet ngritur një organ ndërkombëtar për t'i ndihmuar në harmonizimin e tyre?



Ripërcaktimi i mbikëqyrjes së sigurimeve për “normalitetin e ri” – publikim i përbashkët IAIS-FSI

<https://www.iaisweb.org>

Tarzana Badat,
Denise Garcia Ocampo
Jeffery Yong

Pandemia Covid-19 testoi qëndrueshmërinë operacionale dhe përshtatshmërinë e siguruesve dhe autoriteteve mbikëqyrëse në të gjithë botën. Shumë nga sfidat me të cilat u ballafaquan mbikëqyrësit e këtij tregu, si edhe rregullimet e ndjekura gjatë kësaj kohe, do të shërbejnë si një bazë për të formuar “normalitetin e ri” të së ardhmes, në mbikëqyrjen e sigurimeve, përtej krizës aktuale.

IAIS dhe disa mbikëqyrës të tregut të sigurimeve, në bashkëpunim edhe me Institutin e Stabilitetit Financiar (FSI) studiuin dhe njohën gjerësisht masat që mbikëqyrës të ndryshëm në tregun e sigurimeve morën gjatë kësaj periudhe pandemie për të ndihmuar në përbalimin e saj. Ky publikim i përbashkët i IAIS dhe FSI përshkruan se si mbikëqyrësit e sigurimeve vepruan duke punuar në distancë dhe se si ky tranzicion ndikoi në proceset dhe aktivitetet e tyre mbikëqyrëse. Studimi nënvizon edhe aspektet vitale të burimeve njerëzore dhe kohezionit midis ekipeve të punës, gjë që u mundësoi mbikëqyrësve të përshtaten më mirë me këto kalime. Duke përdorur mësimet e nxjerra nga kriza, në këtë publikim eksplorohej edhe ndikimet e mundshme afatgjata të punës në distancë dhe propozohen disa çështje për t’u pasur në vëmendje nga mbikëqyrësit e sigurimeve, ndërkohë që ata vazhdojnë të përshtaten me digjitalizimin dhe të ardhmen e re pas Covid.



Pikat kryesore të studimit përfshijnë:

- ❑ Mësimet e nxjerra nga kriza Covid-19 do të jenë shumë të rëndësishme për mbikëqyrjen e sigurimit të së ardhmes. Proceset e mbikëqyrjes së efektshme dhe të shkathët mbështetur nga infrastruktura digjitale, elastike dhe bashkëpunimi i sigurveve edhe me agjencitë e tjera rregullatore, do të jenë shumë të rëndësishme për të ndihmuar mbikëqyrësit e sigurimeve të përballen me problematika të papritura në të ardhmen;
- ❑ Mbikëqyrja e sigurimeve në normalitetin e ri do të ripërcaktojë ndarjen midis mbikëqyrjes *on-site* dhe *off-site* (asaj në vend dhe mbikëqyrjes nga distanca), ku elementet e mbikëqyrjes në distancë do të jenë shtyllë kryesore, për të mundësuar mbikëqyrje më efikase dhe efektive në të ardhmen. Sidoqoftë, mbikëqyrja në distancë nuk mund të zëvendësojë plotësisht mbikëqyrjen në vend, veçanërisht në vlerësimin e aspekteve të sjelljes të sigurveve;
- ❑ Do të nevojiten struktura/ekipe të duhura mbështetëse, për të siguruar në vijim shëndetin dhe mirëqenien e ekipeve mbikëqyrëse të sigurimeve;
- ❑ Pandemia përshpejtoi digjitalizimin si të proceseve mbikëqyrëse të sigurimeve ashtu edhe të zinxhirit të vlerës së biznesit të sigurimeve. Ndërkohë që ritmi dhe shkalla e transformimit digjital vazhdon të rritet, po kështu rriten edhe rreziqet e sigurisë kibernetike dhe mbrojtja e konsumatorit në sigurime;
- ❑ Mbikëqyrësit, në të ardhmen, do të duhet të zbatojnë një qasje më gjithëpërfshirëse për investimet në teknologji. Adoptimi i teknologjive të reja mbikëqyrëse do të duhet të plotësohet me programe të ndërtimit të kapaciteteve që u japin mbikëqyrësve aftësi të reja digjitale, të nevojshme për t'u përshtatur sistemeve të mbikëqyrjes në normalitetin e ri.

SUPERVISION OF INFRASTRUCTURE INVESTMENTS BY PENSION FUNDS

Nina Paklina
Dariusz Stańko
April 2021



© IOPS 2021



Publikohet “Material Diskutimi” Nr. 36, prill 2021, i IOPS-it rreth mbikëqyrjes efektive të pensioneve - “Mbikëqyrja e investimeve në infrastrukturë nga fondet e pensionit”

Nina Paklina
Dariusz Stańko

Prill 2021

Përqindja e të ardhurave të pensionit që vijnë nga pensionet private po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme. Krahas saj, është thelbësore edhe cilësia dhe efektiviteti i mbikëqyrjes së tyre.

Seria e publikimeve si Materialeve të Diskutimit të IOPS ka filluar në gusht 2007 dhe e ka vënë theksin në një sërë sfidash që duhen përmbushur në zhvillimin e sistemeve kombëtare të mbikëqyrjes së pensioneve.

Materialet e Diskutimit rishikojnë natyrën dhe efektivitetin e sistemeve të reja dhe të atyre tashmë të konsoliduara të mbikëqyrjes së pensioneve, duke sjellë shembuj, përvoja dhe mësim të nxjerra për të mirën e anëtarëve të IOPS-it dhe komunitetit të gjerë të pensioneve.

Dokumentet e punës të IOPS nuk janë botime zyrtare. Ato paraqesin rezultate dhe analiza paraprake. Ato shkëmbehen midis anëtarëve për të inkurajuar diskutimet dhe komentet.

Çdo përdorim ose citim duhet të marrë parasysh këtë karakter provizor. Gjetjet dhe konkluzionet e punimeve pasqyrojnë pikëpamjet e autorëve dhe mund të mos përfaqësojnë mendimet e anëtarësisë në IOPS si një e tërë.

BULLGARI

www.xprimm.com

Të dhënat e publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare – FSC të Bullgarisë, paraqesin ecurinë vjetore të tregut të sigurimeve në vend. Tregu i sigurimeve në vend, në fund të vitit 2020 arriti vlerën e 2.88 miliardë BGN, ose rreth 1.47 miliardë EUR. Kjo shifër tregon një rënie prej rreth 0.88% krahasuar me vitin 2019.

Volumi i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve të Jetës ra me 10.46% duke arritur në 446.73 milionë BGN, ose rreth 228.41 milionë EUR. Ndërsa primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës u rritën me 1.10%.

Fitimet neto të shoqërive të sigurimit në fund të vitit 2020 u rritën me 26.16% në terma vjetorë duke arritur në 186.27 milionë BGN, rreth 95.24 milionë EUR. Kjo rritje vjen më shumë nga rritja e vërejtur në tregun e Jo-Jetës me afro 38.87%, ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës shënoi rënie rreth 26.59% për siguruesit.

POLONI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të fundvitit nga Autoriteti Polak i Mbikëqyrjes Financiare (KNF), tregu më i madh i sigurimeve i Evropës Qendrore dhe Lindore në fund të vitit 2020 arriti një vlerë totale të primeve të shkruara bruto prej 63.42 miliardë PLN (monedha vendase) ose rreth 13.74 miliardë euro. Gjatë këtij viti primet e shkruara bruto u ulën me 0.6%.

Gjatë vitit 2020 shuma e dëmshpërblimeve të paguara arriti në 39.65 miliardë PLN, ose rreth 8.59 miliardë euro, që përfaqëson një rënie me gati 3%.

Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës realizoi 42.67 miliardë PLN prime të shkruara bruto ose 0.26% më shumë se vitin e kaluar. Ndërsa kompaninë e sigurimeve të Jetës realizuan rreth 20.74 miliardë PLN. Sigurimet e Jetës patën ulje të vëllimit të primeve të shkruara bruto, shkaktuar kryesisht nga ulja prej 14% e vëllimit të primeve në produktet e sigurimit të Jetës të lidhura me skema kursimesh.

REPUBLIKA E SLLOVAKISË

www.xprimm.com

Sipas statistikave të botuara nga Banka Kombëtare e Sllovakisë (NBS), gjatë vitit 2020, tregu sllovak i sigurimeve arriti në 2.17 miliardë euro, duke shënuar rënie prej rreth 4.75% më pak krahasuar me një vit më parë.

Rënia është e lidhur më tepër me segmentin e tregut të sigurimeve të Jetës. Kështu vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ul me 12,37% në terma vjetorë, duke arritur në 889 milionë euro. Sigurimi i Jetës zë rreth 40,87% të totalit të tregut të sigurimeve. Ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës, gjatë vitit 2020 arriti në 1.28 miliardë euro prime të shkruara bruto ose rreth 1.36% më shumë se viti i kaluar.

Vlera totale e dëmeve të paguara nga siguruesit në vend gjatë vitit 2020 u ul me më shumë se 160 milionë euro, duke arritur në 1.25 miliardë euro. Më tepër se gjysma e dëmeve të paguara, prej 629 milionë euro kishin të bënin me dëmshpërblimet për kontratat e sigurimit të Jetës.

SLLOVENIA

<https://www.zav-zdruzenje.si>

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve (*The Slovenian Insurance Association, SIA*) gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në mbi 1,451.7 milionë euro. Pjesën më të madhe të tyre, me rreth 74% të totalit e zinin primet e shkruara bruto në sigurimet e Jo-Jetës. Ndërsa vetëm 24% ishin prime të shkruara bruto në kontratat e sigurimit të Jetës. Sipas këtyre të dhënave, rritja në tremujorin e parë ka qenë më pak se 1% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2020. Kjo rritje lidhet më shumë me kontratat në sigurimet e Jo-Jetës, pasi sigurimet e Jetës kanë pësuar rënie gjatë tremujorit të parë 2021 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021, ndër klasat e sigurimeve të Jo-Jetës që zunë përqindjen më të madhe ndaj totalit të primeve në nivel tregu ishin:

- “Sigurimi i shëndetit” me rreth 23%;
- “MTPL” me rreth 10.35%;
- “Sigurimi nga zjarri dhe forcat e natyrës” me rreth 7.35%;
- “Dëmtime të tjera në pronë” me rreth 7.33%



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | ëëë.amf.gov.al